


Tregtia e jashtme e mallrave

Shtator 2019

Tiranë, më 17 Tetor 2019: Në Shtator 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u ulur me 5,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u rritur me 23,4 %, në krahasim me Gusht 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 52 mld lekë, duke u rritur me 2,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 0,7 %, në krahasim me Gusht 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 27 mld lekë, duke u rritur me 10,0 %, krahasuar me Shtator 2018 dhe duke u ulur me 13,7 %, në krahasim me Gusht 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në nëntëmujorin e parë të vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 225 mld lekë, duke u ulur me 2,8 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 481 mld lekë, duke u rritur me 3,0 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 256 mld lekë, duke u rritur me 8,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rënia vjetore e eksporteve prej 5,5 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -4,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -3,8 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,4 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +0,7 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +0,5 pikë përqindje.

Për publikim 17/10/2019

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Shtator 2019




Eksportet, gjatë këtij nëntëmujori janë ulur me -2,8 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,3 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,3 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +1,7 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,6 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 2,0 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Produkte kimike dhe plastike” me +1,6 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,7 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +0,5 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar negativisht grupi: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,6 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -0,6 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,3 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Shtator 2019



Si nëntëmujor, importet janë rritur me 3,0 %, krahasuar me nëntëmujorin e parë 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +2,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +0,7 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,4 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,5 pikë përqindje dhe “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,2 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Shtator 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Shtator 2018 janë: Spanja (6,0 %), Gjermania (6,4 %), dhe Kina (165,6 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-5,9 %), Kosova (-6,2 %) dhe Greqia (-3,7 %).

Gjatë këtij nëntëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kosova (16,2 %), Gjermania (6,0 %), dhe Kina (16,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-2,1 %), Spanja (-16,1 %) dhe Greqi (-2,7 %).

Në muajin Shtator 2019, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Shtator 2018 janë: Turqia (+30,2 %), Greqia (+4,1 %), dhe Kina (+4,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-5,4 %), Rusia (-14,9 %) dhe Kosova (-10,5 %).

Gjatë këtij nëntëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Kina (16,5 %), Turqia (10,0 %) dhe Greqia (7,9 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-5,5 %), Gjermania (-8,4 %) dhe Serbia (-28,4 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Shtator 2019



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 63,7 %, të gjithë tregtisë. Në Shtator 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 77,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,1 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (33,0 %), Turqia (8,1 %), Greqia (7,9 %) dhe Gjermania (6,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për nëntëmujorin e parë 2019, me vendet e BE zënë 64,4 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Shtator 2019, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,2 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 58,8 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,9 %), Greqia (7,3 %), Turqia (6,2 %) dhe Gjermania (6,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

| Vitet | Muajt | Eksporte (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Importe (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Bilanci Tregtar (mld lekë) | Mbulimi (%) |
|-------|--------------------|------------------------|-------------------------|-----------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------|
| 2000 | | 37 | -23,5 | 157 | -1,5 | -120 | 23,6 |
| 2001 | | 44 | 19,1 | 190 | 21,0 | -146 | 23,2 |
| 2002 | | 47 | 7,7 | 210 | 10,6 | -163 | 22,6 |
| 2003 | | 54 | 14,7 | 226 | 7,4 | -172 | 24,1 |
| 2004 | | 62 | 14,0 | 236 | 4,5 | -174 | 26,3 |
| 2005 | | 66 | 6,0 | 262 | 11,1 | -196 | 25,1 |
| 2006 | | 77 | 17,6 | 299 | 14,1 | -222 | 25,9 |
| 2007 | | 97 | 25,5 | 376 | 25,8 | -279 | 25,8 |
| 2008 | | 113 | 15,8 | 440 | 16,9 | -327 | 25,6 |
| 2009 | | 105 | -7,2 | 429 | -2,5 | -324 | 24,4 |
| 2010 | | 162 | 54,6 | 478 | 11,4 | -316 | 33,8 |
| 2011 | | 197 | 21,9 | 544 | 13,9 | -347 | 36,2 |
| 2012 | | 213 | 8,2 | 528 | -2,9 | -315 | 40,3 |
| 2013 | | 246 | 15,7 | 517 | -2,1 | -271 | 47,6 |
| 2014 | | 256 | 3,8 | 552 | 6,7 | -296 | 46,3 |
| 2015 | | 243 | -4,9 | 545 | -1,4 | -302 | 44,7 |
| 2016 | | 243 | 0,1 | 579 | 6,4 | -336 | 42,0 |
| 2017 | | 273 | 12,1 | 626 | 8,1 | -353 | 43,6 |
| 2018 | | 310 | 13,7 | 641 | 2,4 | -331 | 48,4 |
| 2017 | 01 - 17 | 19 | 15,6 | 35 | 0,9 | -16 | 53,8 |
| | 02 - 17 | 20 | 14,2 | 44 | 5,1 | -24 | 45,7 |
| | 03 - 17 | 24 | 22,0 | 54 | 14,9 | -30 | 43,8 |
| | 04 - 17 | 24 | 13,7 | 50 | -3,9 | -26 | 48,1 |
| | 05 - 17 | 24 | 18,2 | 56 | 7,4 | -31 | 43,6 |
| | 06 - 17 | 23 | -0,1 | 57 | 9,2 | -34 | 39,7 |
| | 07 - 17 | 25 | 9,9 | 55 | 9,6 | -30 | 45,1 |
| | 08 - 17 | 18 | 12,3 | 49 | 6,2 | -31 | 37,4 |
| | 09 - 17 | 24 | 17,0 | 53 | 10,9 | -29 | 45,1 |
| | Janar - Shtator 17 | 201 | 28,3 | 453 | 20,5 | -252 | 44,3 |
| 2018 | 01 - 18 | 24 | 24,5 | 45 | 27,5 | -21 | 52,5 |
| | 02 - 18 | 24 | 18,8 | 46 | 4,4 | -22 | 52,0 |
| | 03 - 18 | 27 | 14,6 | 55 | 2,5 | -28 | 49,0 |
| | 04 - 18 | 27 | 11,3 | 53 | 5,2 | -26 | 50,9 |
| | 05 - 18 | 30 | 24,3 | 57 | 2,1 | -27 | 53,1 |
| | 06 - 18 | 27 | 18,1 | 54 | -4,6 | -28 | 49,2 |
| | 07 - 18 | 27 | 8,2 | 58 | 6,0 | -31 | 46,0 |
| | 08 - 18 | 20 | 10,8 | 48 | -2,3 | -28 | 42,4 |
| | 09 - 18 | 26 | 8,9 | 51 | -4,4 | -25 | 51,4 |
| | Janar - Shtator 18 | 232 | 15,3 | 467 | 3,1 | -236 | 49,6 |
| 2019 | 01 - 19 | 22 | -7,3 | 42 | -6,2 | -20 | 51,9 |
| | 02 - 19 | 23 | -5,3 | 50 | 8,5 | -27 | 45,4 |
| | 03 - 19 | 28 | 2,7 | 56 | 1,4 | -28 | 49,6 |
| | 04 - 19 | 27 | 0,1 | 57 | 8,9 | -30 | 46,7 |
| | 05 - 19 | 28 | -8,0 | 59 | 4,0 | -31 | 47,0 |
| | 06 - 19 | 26 | -4,1 | 53 | -1,4 | -28 | 47,9 |
| | 07 - 19 | 28 | 3,7 | 60 | 2,7 | -32 | 46,4 |
| | 08 - 19 | 20 | -1,8 | 52 | 7,1 | -32 | 38,8 |
| | 09 - 19 | 25 | -5,5 | 52 | 2,0 | -27 | 47,6 |
| | Janar - Shtator 19 | 225 | -2,8 | 481 | 3,0 | -256 | 46,8 |

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

| | Eksporte | | | | Importe | | | |
|-----------------------|---------------|---------------|-----------------|-----------------|---------------|---------------|-----------------|-----------------|
| | Shtator 2018 | Shtator 2019 | Jan.- Sht. 2018 | Jan.- Sht. 2019 | Shtator 2018 | Shtator 2019 | Jan.- Sht. 2018 | Jan.- Sht. 2019 |
| Vendet e BE-së | 20.096 | 19.261 | 176.805 | 171.454 | 31.217 | 29.700 | 287.771 | 283.083 |
| Austri | 151 | 87 | 1.300 | 1.350 | 578 | 578 | 5.026 | 5.253 |
| Mbretëri e Bashkuar | 85 | 56 | 697 | 537 | 485 | 438 | 4.322 | 4.227 |
| Gjermani | 978 | 1.041 | 10.183 | 10.788 | 3.475 | 3.586 | 36.269 | 33.223 |
| Greqi | 1.122 | 1.081 | 9.812 | 9.544 | 4.760 | 4.957 | 39.051 | 42.138 |
| Itali | 13.188 | 12.414 | 111.734 | 109.351 | 13.665 | 12.925 | 129.782 | 122.653 |
| Spanjë | 2.141 | 2.270 | 17.861 | 14.984 | 2.059 | 692 | 11.020 | 8.358 |
| Kroaci | 65 | 69 | 645 | 787 | 480 | 536 | 4.779 | 5.204 |
| Të tjera të BE-së | 2.365 | 2.244 | 24.574 | 24.113 | 5.714 | 5.989 | 57.523 | 62.027 |
| Kinë | 243 | 644 | 4.140 | 4.813 | 4.300 | 4.496 | 38.027 | 44.317 |
| Kosovë | 2.609 | 2.446 | 19.465 | 22.625 | 849 | 759 | 6.441 | 5.900 |
| Maqedonia e Veriut | 756 | 739 | 6.483 | 6.276 | 935 | 758 | 7.023 | 6.364 |
| Rusi | 2 | 1 | 31 | 75 | 1.034 | 880 | 10.399 | 8.603 |
| SHBA | 738 | 209 | 3.925 | 2.970 | 906 | 981 | 6.709 | 7.978 |
| Turqi | 177 | 251 | 1.556 | 1.607 | 4.582 | 5.964 | 38.503 | 42.343 |
| Ukrainë | 20 | 5 | 178 | 120 | 173 | 147 | 1.981 | 2.414 |
| Zvicër | 51 | 74 | 2.783 | 633 | 626 | 933 | 6.824 | 11.094 |
| Të tjera | 1.522 | 1.143 | 16.138 | 14.379 | 6.402 | 7.437 | 63.329 | 69.069 |
| Gjithsej | 26.213 | 24.774 | 231.504 | 224.951 | 51.022 | 52.054 | 467.007 | 481.166 |

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

| Grup-mallrat | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---------------------------------|---------------|---------------|----------------|----------------|---------------|---------------|----------------|-----------------|
| | Shtator 2018 | Shtator 2019 | Jan.- Sht.2018 | Jan.-Sht. 2019 | Shtator 2018 | Shtator 2019 | Jan.- Sht.2018 | Jan.- Sht. 2019 |
| Gjithsej | 26.213 | 24.774 | 231.504 | 224.951 | 51.022 | 52.054 | 467.007 | 481.166 |
| Ushqime. pije. duhan | 2.553 | 2.685 | 22.335 | 25.418 | 8.827 | 9.192 | 80.278 | 82.316 |
| Minerale. lëndë djegëse. en.el. | 4.092 | 4.716 | 44.065 | 36.447 | 5.249 | 5.515 | 47.272 | 58.378 |
| Produkte kimike dhe plastike | 901 | 684 | 4.583 | 5.890 | 6.754 | 7.584 | 65.014 | 65.410 |
| Lëkurë dhe artikujt prej tyre | 229 | 205 | 2.145 | 1.835 | 1.505 | 1.351 | 13.992 | 13.002 |
| Prodhime druri dhe letre | 851 | 808 | 6.464 | 7.042 | 1.972 | 2.242 | 18.412 | 19.209 |
| Tekstile dhe këpucë | 10.879 | 9.890 | 93.023 | 90.297 | 7.526 | 7.505 | 63.925 | 64.416 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 4.628 | 3.480 | 40.167 | 34.843 | 6.586 | 6.258 | 57.660 | 60.780 |
| Makineri. pajisje dhe pj. këmb. | 1.442 | 1.612 | 12.597 | 16.516 | 10.862 | 10.550 | 102.217 | 99.932 |
| Të tjera | 637 | 693 | 6.126 | 6.663 | 1.742 | 1.857 | 18.236 | 17.724 |

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

| | Itali | | Kosovë | | Spanjë | | Gjermani | |
|--|----------------|----------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 |
| Gjithsej | 111.734 | 109.351 | 19.465 | 22.625 | 17.861 | 14.984 | 10.183 | 10.788 |
| Ushqim. pije duhan | 5.533 | 6.108 | 2.038 | 2.723 | 917 | 947 | 1.060 | 1.199 |
| Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike | 3.765 | 4.474 | 4.396 | 5.479 | 14.233 | 12.079 | 1.684 | 806 |
| Produkte kimike dhe plastike | 1.161 | 1.555 | 968 | 1.574 | 44 | 47 | 23 | 53 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 1.577 | 1.530 | 6 | 5 | 189 | 159 | 6 | 10 |
| Prodhime druri dhe letre | 4.488 | 4.720 | 342 | 649 | 5 | 4 | 121 | 122 |
| Tekstile dhe këpucë | 71.639 | 70.316 | 85 | 76 | 2.294 | 1.583 | 5.301 | 5.667 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 13.296 | 10.296 | 10.026 | 10.279 | 139 | 154 | 572 | 1.233 |
| Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi | 7.438 | 7.534 | 641 | 547 | 30 | 6 | 1.004 | 1.123 |
| Të tjera | 2.837 | 2.819 | 963 | 1.292 | 10 | 4 | 412 | 575 |

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

| | Itali | | Kinë | | Turqi | | Greqi | |
|--|----------------|----------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 |
| Gjithsej | 129.782 | 122.653 | 38.027 | 44.317 | 38.503 | 42.343 | 39.051 | 42.138 |
| Ushqim. pije duhan | 13.199 | 14.503 | 518 | 610 | 4.248 | 4.169 | 11.594 | 11.919 |
| Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike | 9.717 | 6.788 | 6 | 5 | 583 | 1.778 | 6.416 | 9.761 |
| Produkte kimike dhe plastike | 13.685 | 13.671 | 3.582 | 4.250 | 6.033 | 5.946 | 5.765 | 5.807 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 10.719 | 10.327 | 570 | 585 | 234 | 205 | 47 | 22 |
| Prodhime druri dhe letre | 5.449 | 5.031 | 840 | 773 | 2.447 | 2.547 | 2.530 | 2.628 |
| Tekstile dhe këpucë | 31.424 | 30.365 | 7.456 | 8.607 | 11.910 | 13.031 | 2.752 | 2.708 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 15.405 | 14.201 | 5.194 | 7.153 | 5.668 | 8.098 | 6.442 | 6.131 |
| Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi | 25.802 | 23.774 | 16.190 | 18.204 | 5.591 | 5.006 | 2.143 | 2.029 |
| Të tjera | 4.380 | 3.994 | 3.672 | 4.130 | 1.788 | 1.563 | 1.362 | 1.133 |

Metodologjia

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Slovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri